




Elite Travel Agency

EKSPLORO



BOTËN

UDHËTIM NË EGJIPT
9 SHKURT 2026



FLUTURIMET

Fluturimi Shqipëri – Egjipt 09 Shkurt 2026 (Aegean Airlines)

Tiranë (TIA) – Athinë (ATH) : 10:05 – 12:20

Athinë (ATH) – Cairo (CAI) : 18:00 – 19:55

Fluturimi Egjipt – Shqipëri 15 Shkurt 2026 (Aegean Airlines)

Cairo (CAI) – Athinë (ATH) : 10:00 – 12:10

Athinë (ATH) – Tiranë (TIA) : 17:40 – 18:00



ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



ITINERARI



Dita 1 : Tiranë – Kairo

Udhëtimi ynë nis me takimin me guidën rreth orës 07:00 në aeroport. Nisja nga Tirana në orën 10:05. Udhëtojmë drejt Athinës, mbërrimë në orën 12:20. Marrim fluturimin për në Kairo në orën 18:00. Mbërritja në orën 19:55.

Me të mbërritur në Aeroportin Ndërkombëtar të Kairos, do të takohemi me partnerët dhe do të transferohemi në hotelin tonë për të bërë check-in. Pas një udhëtimi të gjatë, do të shijojmë një darkë të këndshme në restorantin e hotelit përpara se të pushojmë natën.

Fjetja në **Swiss Inn Pyramids Golf 4***.

Vaktet e përfshira : Darka

Dita 2 : Kairo – Piramidat dhe Sfinksi

Zgjohehi dhe konsumojmë mëngjesin në hotel. Këtu do të bëjmë dhe takimin me guidën tonë vendase. Pas një mëngjesi të bollshëm, nisemi për të vizituar një prej mrekullive më të mëdha të botës – Piramidat e Gizës. Do të shijojmë pamjen madhështore të Keopsit, Kefrenit dhe Menkaurës, monumente që mishërojnë fuqinë dhe përjetësinë e faraonëve egjiptianë. Do të ndalemi gjithashtu pranë Sfinksit enigmatik, një simbol që bashkon figurën njerëzore me trupin e luanit, duke ruajtur prej mijëra vitesh misteret e Luginës së Piramidave.

Ky është një moment ku historia dhe mitologjia egjiptiane bashkohen në një pamje mahnitëse që mbetet e paharrueshme për çdo vizitor.

Do të konsumojmë drekën. Pas drekës do të kemi mundësi të bëjmë një Vizitë opsionale në Grand Egyptian Museum.

Grand Egyptian Museum (GEM) është një nga atraksionet më të mëdha dhe më mbresëlënëse në botë, duke ofruar një udhëtim të jashtëzakonshëm përmes historisë antike të Egjiptit. I vendosur pranë Piramidave të Giza-s, ky muze monumental është shtëpia e më shumë se 100,000 artefakteve të çmuara, duke përfshirë thesaret e faraonëve më të njohur, përfshirë maska të arta dhe statuja madhështore. Vizitorët mund të përjetojnë një udhëtim të paharrueshëm mes artefakteve të lashta dhe teknologjisë moderne, duke zbuluar misteret e qytetërimit më të vjetër në botë. Me arkitekturën e saj mahnitëse dhe hapësirat e jashtëzakonshme, Grand Egyptian Museum është një destinacion që nuk duhet humbur për çdo dashamirës të historisë dhe kulturës.

Mbrëmjen e kemi të lirë për të pushuar ose për të shijuar atmosferën e qetë të Kairos.

Kthehemi në hotel për të pushuar. Fjetja në **Swiss Inn Pyramids Golf 4***.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



ITINERARI

Dita 3 : Kairo – Aswan dhe Lundrim në Nil

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Pas mëngjesit, do të transferohemi për në aeroport për të marrë fluturimin për në Aswan.

Pasi të mbërrijmë, do të fillojmë vizitat tona me Digën e Madhe të Aswanit, një prej veprave më të mëdha inxhinierike në botë, që kontrollon rrjedhën e lumit Nil dhe ka krijuar Liqenin Naser, një liqen gjigant artificial që furnizon me energji të gjithë Egjiptin jugor.

Më pas do të vizitojmë Parkun e Gurit të Kuq dhe Obeliskun e Papërfunduar, një dëshmi mbresëlënëse e mjeshtërisë së egjiptianëve të lashtë në nxjerrjen dhe përpunimin e granitit, e cila tregon teknikat e sofistikuara të ndërtimit që përdornin më shumë se 3,000 vjet më parë.

Në përfundim të vizitave, do të ngjitemi në kroçerën tonë luksoze me 5*, ku do të akomodohehi dhe do të shijojmë një drekë të këndshme në bord, duke nisur udhëtimin tonë përgjatë lumit më të famshëm të botës.

Në orët e pasdites, do të shijojmë një shëtitje të qetë me felucca, varkën tradicionale egjiptiane. Ky udhëtim ofron një pamje magjike të jetës përgjatë brigjeve të lumit, një moment relaksi pas një dite plot aktivitete.

Këtu do të kemi mundësi dhe për një vizitë opsionale në fshatin Nubian, një udhëtim i paharrueshëm në traditën dhe kulturën e lashtë të Egjiptit.

Konsumojmë darkën në bord dhe Fjetja në **Kroçere (Iberotel Crown Empress) 5***.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 4 : Kom Ombo dhe Edfu

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në bord, duke shijuar pamjet e mrekullueshme të luginës së Nilit drejt **Kom Ombos**.

Paradite kemi mundësi për një vizitë opsionale në Abu Simel. Abu Simbel është një nga monumentet më madhështore dhe më të njohura të Egjiptit, një kryevepër e arkitekturës dhe artit të lashtë egjiptian. Ky kompleks tempulli, i ndodhur në jug të Egjiptit, afër liqenit Nasser, përfshin dy tempuj të mëdhenj të ndërtuar nga faraoni Ramzi II për t'i dedikuar perëndive dhe nderuar veten. Tempulli i madh i Abu Simbel është i famshëm për katër statuja gjigande të faraonit Ramzi II që mbizotërojnë hyrjen dhe të cilat janë një nga pamjet më ikonike të Egjiptit. Ky vend, i cili dikur ishte vendosur në bregun e Nilit, u rrezikua nga ndërtimi i digës Aswan, por me një projekt të madh inxhinierik, tempulli u shpëtua dhe u lëviz për të ruajtur trashëgiminë e tij. Abu Simbel është një eksperiencë e jashtëzakonshme që sjell të gjallë historinë e faraonëve dhe mahnitëse e bukurinë e artit të lashtë egjiptian.

Me të mbërritur pas dreke, do të vizitojmë Tempullin unik të Kom Ombos, një nga monumentet më të veçanta të Egjiptit të lashtë, i ndërtuar në nder të dy perëndive – Sobekut, perëndisë me kokë krokodili, dhe Haroerisit (Horusit të Lartë), perëndisë me kokë shqiponje. Ky tempull dallohet për simetrinë e përsosur dhe për relievet e ruajtura me hollësi, të cilat tregojnë skena të jetës fetare dhe mjekësisë egjiptiane.

Do të shikojmë gjithashtu Nilometrin, një mjet i lashtë i përdorur për të matur nivelin e ujit të lumit Nil – një element thelbësor për bujqësinë dhe jetën në Egjiptin e lashtë.

Pas përfundimit të vizitës, kroçera do të vazhdojë rrugëtimin drejt Edfusë, ndërsa ne mund të shijojmë pamjet e mrekullueshme të lumit gjatë lundrimit.

Në mbrëmje, do të shijojmë një darkë të këndshme në kroçerë, ku do të kalojmë dhe natën.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka



ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



ITINERARI

Dita 5 : Edfu – Esna – Luksor

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin në kroçere.

Pas mëngjesit në kroçerë, do të zbresim për të vizituar Tempullin e Edfusë, të dedikuar perëndisë Horus, një nga tempujt më të mirëmbajtur dhe më mbresëlënës të Egjiptit të lashtë. Në këtë tempull madhështor do të admirojmë relievet e ruajtura me përpikmëri dhe arkitekturën monumentale, që dëshmojnë për fuqinë dhe përkushtimin fetar të egjiptianëve të lashtë.

Pas vizitës, kroçera do të vazhdojë rrugëtimin drejt Luksorit, duke kaluar përmes Digës së Esnës, një moment ku mund të shohim nga afër mënyrën se si kroçerat ngrihen dhe ulen nëpërmjet portave të ujit – një përvojë e rrallë inxhinierike përgjatë lumit Nil.

Konsumojmë darkën dhe kalojmë natën në kroçerë.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi, Dreka dhe Darka

Dita 6 : Lugina e Mbretërve dhe Kairo

Zgjahemi dhe konsumojmë mëngjesin.

Pas mëngjesit në kroçerë, do të nisemi për të eksploruar Luginën e Mbretërve, një prej vendeve më të rëndësishme arkeologjike në botë dhe vendpushimin e përjetshëm të faraonëve të mëdhenj të Egjiptit të lashtë.

Këtu ndodhen varret e famshme të **Tutankhamunit**, **Ramsesit** dhe shumë të tjerëve, të zbukuruar me afreske që tregojnë udhëtimin e faraonëve drejt jetës së përjetshme.

Më pas do të vizitojmë Tempullin e Medinet Habu, të ndërtuar në nder të Ramsesit III, një nga monumentet më të ruajtura që pasqyron fuqinë ushtarake dhe fetare të sundimit të tij.

Do të vazhdojmë me vizitën në Tempullin e Deir El Baharit, një vepër arkitekture madhështore, dedikuar Mbretëreshës Hatshepsut, gruas që sundoi si faraon dhe la pas një trashëgimi të jashtëzakonshme.

Tempulli i saj, i gdhendur në shkëmb, është një nga shembujt më të bukur të harmonisë mes natyrës dhe arkitekturës egjiptiane.

Pas kësaj, do të ndalemi pranë **Kolosëve të Memnonit**, dy statuja gjigante që qëndrojnë si rojtarë të heshtur të Luginës, duke mbartur legjenda të lashta dhe rrëfime që kanë kaluar brez pas brezi.

Në fund do të vizitojmë tempujt e Karnakut dhe Luksorit. Tempulli i Karnak, një kompleks i madh dhe madhështor në qytetin e Luxorit, është një nga komplekset fetare më të mëdha të ndërtuara ndonjëherë. Ky tempull është një testament i lavdisë dhe fuqisë së faraonëve të Egjiptit të Lashtë, i dedikuar perëndisë Amu, dhe përfshin një mori oborresh, sallash, dhe kolona të mëdha, përfshirë Kolonat e Madha të Hypostyle.

Karnak është një vend që pasqyron zhvillimin e artit dhe arkitekturës egjiptiane për shekuj me radhë, me gjithsej 30 faraonë të cilët kontribuan në ndërtimin e tij. Tempulli i Luksorit, i ndodhur vetëm disa kilometra larg nga Karnak, është një tjetër shembull i jashtëzakonshëm i arkitekturës egjiptiane. I ndërtuar gjatë periudhës së faraonëve, ky tempull është një vend i shenjtë që nderon perëndinë Amon, dhe është i njohur për skenat e tij të bukura të gdhendura në mure dhe për dekorimet e tij të jashtëzakonshme. Tempulli i Luksorit është veçanërisht i njohur për shëtitjen e tij të mrekullueshme nëpër të, të quajtur “Avenue of Sphinxes”, që lidh këtë tempull me Tempullin e Karnak-ut.

Pasditë, do të transferohemi për në Aeroportin e Luksorit për fluturimin drejt Kairos.

Akomodohemi në hotel dhe kalojmë natën në **Swiss Inn Pyramids Golf 4***.

Vaktet e përfshira : Mëngjesi dhe Darka





DETAJET E SHËRBIMIT

Kategoria e Hoteleve: 4* & 5 *

Numri i ditëve: 6

Numri i netëve: 5

Qytetet që vizitohen: 5: Cairo, Aswan, Kom Ombo, Edfu, Luxor

Monumentet që vizitohen: 8: Piramidat e Keopsit, Kefreni dhe Mikerini, Sfinksi, Diga e Lartë, Gurorja e Granitit të Kuq dhe Obelisku i Papërfunduar, Tempulli i Kom Ombos, Tempulli i Edfusë, Tempulli i Karnakut, Tempulli i Luksorit, Lugina e Mbretërve, Medinet Habu, Tempulli i Hatshepsutit, Kolosët e Memnonit

Aktivitetet e përfshira: 2: Vizitë turistike në Kajro (zona e Piramidave), lundrim me Felucca në Nil (varkë tradicionale)

Numri total i vakteve të përfshira: 15

Mëngjese : 6

Dreka : 3

Darka: 6

KM: 200-250 km

Kohë totale transporti në rrugë tokësore: 8 orë

Distanca mesatare e përshkruar : 32 KM/Ditë

Koha mesatare e transportit : 1.5 orë/ditë

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)

WWW.ELITETRAVEL.AL



SWISS INN PYRAMIDS GOLF 4*

(8.9 RATING NE BOOKING DHE 4.4 NE GOOGLE)



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



IBEROTEL CROWN EMPRESS 5*



ELITE TRAVEL AGENCY
ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



PËRSE TË UDHËTONI ME NE?

- Paketa të kuruara me kujdes për çdo moshë dhe interes
- Eksperiencia autentike kulturore në çdo destinacion. Cdo dite ka nje moment kulminant, qe eshte nje eksperience dhe nje aktivitet, Unesco Sites.
- Grupi optimal: 15–35 persona për një eksperiencë më personale
- Nuk ka kosto të fshehura – transparencë totale në çmim
- Fluturime të organizuara në grup me linja zyrtare per udhetime nderkontinentale ku bagazhet behen me checkin te plote pa dale nga aeroporti (jo low cost të papërshtatshme) – Bagazhet 23 KG gjithmone te perfshira
- Guida profesioniste dhe të përkushtuara, që flasin gjuhën tuaj
- 25 vite përvojë në organizimin e udhëtimeve cilësore
- Kujtime që zgjasin një jetë – jo thjesht një udhëtim
- Mbështetje 24/7 para, gjatë dhe pas udhëtimit
- Programe të pasura në përmbajtje kulturore dhe edukative
- Akomodim në hotele të përzgjedhura me standartin: 4 Superior / 5
- Vizat gjithmone te perfshira ne cmim

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



INFORMACIONE TË RËNDËSISSHME

Kushtet e Rezervimit dhe Pagesës

6.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti pranon të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për rezervimin e Shërbimit. Pagesa për Shërbimet do të bëhet nga Klienti në mënyrën e mëposhtme:

1. Depozita

- Konfirmimi i rezervimit. Pas konfirmimit të rezervimit, Klienti do të depozitojë shumën prej 25 % të kostos totale të Shërbimit të paketës EB. Kjo depozitë siguron rezervimin e Klientit dhe i lejon Agjencisë të fillojë të bëjë rezervimet e nevojshme.
- Depozitë e Parimbursueshme: 10% e shumës totale të udhëtimit nuk do të jetë e rimbursueshme në asnjë rast nga Operatori i shërbimeve përveç në rrethanat e përcaktuara në Marrëveshje, siç është anulimi nga Operatori i shërbimeve ose ngjarjet e forcës madhore. Kjo politikë është në fuqi për të mbuluar çdo kosto të shkaktuar nga Operatori i shërbimeve në rast të një anulimi.
- Koha e Depozitës: Depozita duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë pas konfirmimit të rezervimit, kur rezervimi bëhet të paktën 3 muaj përpara. Kjo siguron që Operatori i shërbimeve të ketë kohë të mjaftueshme për të bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për udhëtimin e Klientit.

2. Pagesa e pjesës së mbetur të kostos totale

- Pagesa finale: Bilanci i pagesës duhet të paguhet nga Klienti jo më vonë se 45 ditë para datës së fillimit të shërbimit. Kjo i lejon Agjencisë të konfirmojë të gjitha rezervimet dhe të finalizojë të gjitha përgatitjet.
- Pagesa të Vonuara: Moskryerja e pagesave në kohë mund të rezultojë në moskonfirmimin e rezervimeve pa njoftim të mëtejshëm. Kjo politikë është në fuqi për të siguruar që Operatori i shërbimeve të mund të përmbushë angazhimet e saj ndaj ofruesve të shërbimeve.
- Tarifa për Pagesë të Vonuar: Në rast të pagesës së vonuar, Operatori i shërbimeve mund të vendosë një tarifë shtesë pagese prej 10% të shumës së papaguar. Kjo tarifë kompenson Agjencinë për punën shtesë administrative të përfshirë në trajtimin e pagesave të vonuara.

3. Për rezervimet e kryera/konfirmuara jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit:

Për të gjitha rezervimet e kryera brenda këtij afati (jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit deri në ditën e nisjes), rezervimi quhet i konfirmuar në momentin që është kryer 100% e pagesës.

Anulimi dhe Rimbursimet

7.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti mund të anulojë Shërbimet të paketës EB në varësi të kushteve të mëposhtme:

1. Njoftimi dhe Tarifat e Anulimit

1.Njoftim më shumë se 60 ditë: Anulimet e bëra më shumë se 60 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 10% të shumës totale të paketës së turit, tarifë që mbulon kostot administrative që lidhen me anulimin e Shërbimeve të paketës EB.

2.Njoftim më pak se 59 ditë: Anulimet e bëra më pak se 59 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 40% të shumës totale të paketës së turit, tarifë që pasqyron vështirësinë e plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

3.Njoftim më pak se 30 ditë: Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai më pak se 30 ditë përpara udhëtimit, klientit nuk i kryhet asnjë rimbursim nga ana e kompanisë, tarifë që pasqyron vështirësinë në rritje të plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

4.Mosparaqitje: Në rast mosparaqitjeje, nuk do të jepet rimbursim. Kjo politikë është në fuqi sepse Operatori i shërbimeve do të kishte bërë të gjitha rregullimet e nevojshme dhe nuk do të ishte në gjendje të rikuperonte këto kosto.

5.Anulimi i paketave të shërbimit për kategorinë “Eksploro Botën” mund të realizohet vetëm ndërmjet një kërkesë të paraqitur me shkrim, përmes emailit zyrtar, aplikacionit WhatsApp, ose me paraqitje fizike në zyrat e Elite Travel LCC Tiranë. Çdo kërkesë verbale, telefonike apo e paformalizuar me një dokument të shkruar nuk do të konsiderohet e vlefshme për procedurat e anulimit.

Me kryerjen e rezervimit dhe dërgimin e konfirmimit nga ana e Klientit, pavarësisht formës së tij (me shkrim, elektronik, përmes emailit, WhatsApp-it, pagesës së depozitës apo pagesës së plotë), kjo kontratë konsiderohet e pranuar plotësisht dhe pa asnjë kusht nga Klienti.

Ju lutemi për informacion më të detajuar vizitoni linkun për Kontratën me Klientin. [Klikoni këtu](#)

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



Elite Travel Agency

Everlasting Experiences

WWW.ELITETRAVEL.AL